Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE
Nr. 13-111/01-0068793/26
Datë 04.11.2026

Në bazë të nenit 95 dhe 96 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), nenit 5 të Rregullores (QRK) nr.27/2024 për procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendit të punës, Komuna e Podujevës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lire/Zëvendësim	Numri i pozitave
1.	SHFMU	Punëtor teknik	"Ilir Konushefci "- Llugë	1

Detyrat kryesore të punës:
- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lendeve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;.
- Të përkujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për rregullimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:
- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:
- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;

- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- CV duhet të përmbajë të dhënat personale, një përshkrim të përvojës së punës, duke përfshirë: punëdhënësin, funksionin, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, një përshkrim të shkurtër të detyrave të punës, adresën e punëdhënësit, njohuritë gjuhësore, informata mbi trajnimet e kryera dhe kualifikimet profesionale (nëse ka).
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve).

Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi profesional përbëhet nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit dhe zhvillohet nga Komisioni i Përzgjedhjes
- Në vlerësim, kandidati mund të merr më së shumti njëqind (100) pikë, prej të cilave deri në tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV) dhe deri në shtatëdhjetë (70) pikë për intervistën.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Data e aplikimit: në web-faqen unike të procedurave të konkurimit https://konkursi.rks-gov.net është prej datës **05.11.2026** deri më datën **19.11.2026.**

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës-http://kk.rks-gov.net/podujeve po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (https://konkursi.rks-gov.net). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës http://kk.rks-gov.net/podujeve/ dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët të ruajnë dëshmit e aplikimit, e cila është e domodsdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në LZP.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të të kontaktohen.